



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZL. Anr.333/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët : Bujar Muzaqi, kryesues, Violeta Husaj Rugova dhe Hajriz Hoti anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e e kandidatit për Kryetar të Komunës së Mamushës Abdulhadi Krasaniç nga subjekti politik Kosova Demokratik Turk Partisi (KDTP), me seli në Prizren, dega Mamushë, të paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të parregullsive gjatë votimit, për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës të mbajtura me datën 12 Tetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur, më datë 25.10.2025, merr këtë:

V E N D I M

REFUZOHET E PABAZUAR ankesa, ZL. Anr.333/2025 datë 23.10.2025, parashtruar nga kandidati për Kryetar të Komunës së Mamushës Abdulhadi Krasaniç nga subjekti politik Kosova Demokratik Turk Partisi (KDTP), me seli në Komuna Prizren, dega Mamushë, të parashtruar kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të parregullsive gjatë votimit, për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës të mbajtura me datën 12 Tetor 2025.

A r s y e t i m

Me datë 23.10.2025, PZAP-i, ka pranuar ankesë nga subjekti politik Kosova Demokratik Turk Partisi (KDTP), me seli në Prizren, dega Mamushë, në të cilën kandidati për Kryetar të Komunës së Mamushës thekson se në emër të Partisë "Kosova Demokratik Turk Partisi" dhe në cilësinë kandidati për Kryetar të Komunës së Mamushës, parashtron ankese duke paraqitur shqetësime serioze lidhur me vlefshmërinë e votave të ardhura nga diaspora dhe dyshimet për keqpërdorime në procesin e votimit, ku ekziston dyshimi i bazuar se disa persona të përfshirë në procesin e votimit nga diaspora kanë ushtruar të drejtën e votës në kundërshtim të drejtpërdrejtë me dispozitat kushtetuese. Këta persona, sipas aktgjyqimeve të formës së prerë të Gjykatës Themelore në Prizren-Departamenti për Krime të Rënda, nr. PKR.nr.65/24, të cilat janë vërtetuar nga Gjykata e Apelit me nr. PAKR.nr.688/2024, iu është hequr shtetësia e Republikës së Kosovës për shkak të parregullsive të konstatuara gjatë regjistrimit në regjistrat civilë dhe procedurave administrative të Agjencisë për Regjistrim Civil. Bazuar në Nenin 45 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, e drejta për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur i takon ekskluzivisht shtetasve të Republikës së Kosovës dhe kufizohet kur ekziston vendim gjyqësor i formës së prerë. Çdo votë e ushtruar nga persona që kanë humbur shtetësinë përbën shkelje të drejtpërdrejtë të kësaj dispozite kushtetuese dhe cenim të rëndë

të integritetit të procesit zgjedhor. Ky fakt ngre dyshime të arsyeshme se një pjesë e votave të ardhura nga diaspora janë dhënë nga persona që nuk kanë pasur të drejtë ligjore për të votuar, duke rrezikuar rezultatin e zgjedhjeve dhe besimin e publikut në procesin demokratik. Përveç këtij dyshimi, ekziston shqetësimi lidhur me vendvotimin 3201/04, ku ka pasur shkelje të procedurës së votimit me asistencë. Konkretisht, i njëjti person ka ushtruar rolin e asistentit për më shumë se një votues, gjë që është e ndaluar me ligjin zgjedhor dhe udhëzimet e KQZ-së. Procedura e asistencës ka karakter individual dhe mund të kryhet vetëm një herë për një votues të vetëm. Ky veprim përbën ndërhyrje të palejuar në procesin zgjedhor, cenon të drejtën e votës dhe rrit dyshimin për ndikim të jashtëligjshëm në mënyrën e ushtrimit të votës nga disa persona. Kjo kërkon verifikim të pamjeve të kamerave të sigurisë në vendvotimin 3201/04, në mënyrë që të konstatohet numri i rasteve të asistencës së përsëritur dhe identiteti i personit që ka kryer këtë veprim të kundërligjshëm. Kombinimi i dyshimeve-pjesëmarrja e votuesve pa shtetësi dhe keqpërdorimi i procedurës së asistencës-përbën një kërcënim serioz për integritetin, ligjshmërinë dhe transparencën e procesit zgjedhor. Në këtë kontekst, është e domosdoshme që Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për verifikimin e plotë të listave të votuesve nga diaspora, përjashtimin e çdo vote të dhënë nga persona që nuk kanë të drejtë ligjore për të votuar, si dhe hetimin dhe dokumentimin e shkeljeve të procedurës së asistencës në vendvotimin 3201/04. Kjo do të garantonte jo vetëm respektimin e ligjit dhe të Kushtetutës, por edhe ruajtjen e besimit të qytetarëve në procesin demokratik dhe në institucionet zgjedhore të Republikës së Kosovës.

KQZ në përgjigjen në ankesë ndër të tjera thekson se KQZ, pas shqyrtimit të ankesës dhe pretendimeve të palës ankuese në lidhje me kërkesën e juaj jep sqarimet/përgjigjet si në vijim : bazuar në nenin 8 paragrafi 1, dhe 2, nenin 83 të Ligjit Nr. 08/L-228 Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, nenin 3 të Rregullores Zgjedhore Nr.03/2024 Krijimi, Kundërshtimi dhe Konfirmimi i Listës së Votuesve, si dhe nenin 2 të Rregullores Zgjedhore Nr.02/2025 Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Zgjedhore Nr.03/2024 Krijimi, Kundërshtimi dhe Konfirmimi i Listës së Votuesve, bëhet procesi i krijimit të Listës së Votuesve në Republikën e Kosovës. Bazuar në dispozitat e mësipërme, KQZ ju njofton se Lista e votuesve përmban të gjitha informacionet e nevojshme, ndër të tjera edhe Qendrën e Votimit në të cilën votuesi është caktuar për të votuar. Ndërrimi i Qendrës së Votimit bazohet në përditësimet e sakta të Regjistrit Qendror Civil, andaj çdo ndryshim i Qendrës së Votimit, ka ardhur si rezultat i të dhënave të përditësuara të Regjistrit Qendror Civil. Në lidhje me pretendimin e parë të palës ankuese Departamenti i Teknologjisë Informative zgjedhore dhe shërbim të votuesve të KQZ-së ka dhënë sqarimin/përgjigjen si në vijim : krijimi i listës së Votuesve për Zgjedhjet Lokale 2025, është bërë në përputhje me Rregulloren Zgjedhore Nr. 03/2024 për Krijimin, Konfirmimin dhe Kundërshtimin e Listës së Votuesve, e plotësuar me Rregulloren Nr. 02/2025, Brenda 24 orëve pas shpalljes së zgjedhjeve, Divizioni i Shërbimit të Votuesve (DSHV) ka kërkuar nga Agjencia e Regjistrimit Civil (ARC) të dhënat e shtetasve të Republikës së Kosovës që kanë mbushur 18 vjeç ose i mbushin deri në ditën e zgjedhjeve, më 12 qershor 2025 është pranuar ekstrakti i parë i Regjistrit Qendror Civil (RQC), mbi bazën e të cilit DSHV ka përgatitur listën preliminare të votuesve, kjo listë është aprovuar nga KQZ në mbledhjen nr. 41, më 27 qershor 2025, dhe është publikuar në platformën elektronike më 28 qershor 2025. Pas publikimit, lista i është nënshtruar procesit të verifikimit dhe pastrimit në bashkëpunim me institucionet relevante. Si rezultat, në të gjitha komunat anë larguar: 213 persona pa zotësi juridike (verifikim me KGJK), 4,471 persona që

figurojnë të vdekur (verifikim me Departamentin e Pensioneve të MFPT) 471 persona pas verifikimit me Agjencinë e Statistikave të Kosovës, 1,514 persona të konfirmuar të vdekur gjatë verifikimit në terren nga ZEKKZ. Në kuadër të periudhës së kundërshtimit dhe konfirmimit të listës së votuesve (3 korrik 31 gusht 2025) DSHV nuk ka pranuar kërkesë për kundërshtim të listës së votuesve për komunën e Mamushës. Lista e Votuesve është certifikuar nga KQZ më 6 shtator 2025, Sipas kësaj liste, Komuna e Mamushës ka gjithsej 4,739 votues. prej të cilëve 4,383 votues brenda Kosovës dhe 356 votues të regjistruar suksesshëm për votim jashtë Kosovës. Gjatë regjistrimit të votuesve jashtë Kosovës, regjistrimit të votuesve me nevoja të veçanta dhe vlerësimit të zarfeve të votimit me kusht, bazë ka shërbyer Lista e Votuesve e krijuar nga të dhënat e shtetasve sipas RQC të pranuar nga ARC. Prandaj, pala ankuese është dashur që pretendimet e saj t'i paraqesë gjatë periudhës dhe brenda afatit të përcaktuar për paraqitjen e ankesave lidhur me Listën Votuese, afat i cili ka përfunduar më datën 5 shtator 2025. Në këtë drejtim, vlen të theksohet se Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka certifikuar Listën Votuese brenda dhe jashtë Republikës së Kosovës më datën 6 shtator 2025, pas përfundimit të afatit ligjor për ankesa. Në lidhje me pretendimin e dytë të palës ankuese. Bazuar në nenin 89 paragrafi 5 dhe 6 të Ligjit Nr. 08/L-228 Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, dhe Rregulloren Zgjedhore Nr. 12/2024-Votimi, Numërimi në Vendvotim dhe Menaxhimi i Vendvotimit, sipas nenit 10, paragrafët 5, 6, 7 dhe 8, përcaktohet procedura e detajuar për realizimin e votimit me asistencë. Nëse pretendohet se një individ ka asistuar për disa votues për votim me asistencë, atëherë personi përgjegjës kryesor sipas nenit 10.8 të rregullës zgjedhore nr,12/24 është kryesuesi dhe anëtarët e KW, ku thuhet se; kryesuesi dhe anëtarët sigurohen që të parandalojnë keqpërdorimin apo tentimin për keqpërdorim të së drejtës për votim me asistencë. KQZ, pas pranimit të kërkesës nga PZAP, më datën 23.10.2025, ka kontaktuar me Komisionin Komunal të Zgjedhjeve (KKZ) të Komunës së Mamushës nga i cili ka marrë përgjigjen si më poshtë: Sipas procedurave të votimit të miratuara nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (I(QZ), votimi me asistencë lejohet vetëm në rastet kur votuesi ka aftësi të kufizuara fizike, të cilat e pengojnë të votojë vetë dhe këtë e dëshmon me dokument të vlefshëm, ose kur deklaron se nuk di shkrim dhe lexim. Është me rëndësi të theksohet se për zbatimin e drejtë të këtyre rregullave në vendvotime përgjegjës mbetet Këshilli i Vendvotimit (KW), KW është organi që menaxhon procesin e votimit dhe numërimit në vendvotim dhe siguron që votimi të zhvillohet në përputhje me procedurat dhe udhëzimet e KQZ-së. Komisioni Komunal i Zgjedhjeve (KKZ) nuk ka rol të drejtpërdrejtë në këtë aspekt dhe nuk mund të jetë i pranishëm vazhdimisht në çdo vendvotim për të kontrolluar mënyrën e realizimit të votimit me asistencë. Për rrjedhojë, KKZ nuk mban përgjegjësi për mënyrën se si është zhvilluar ky proces në vendvotime të caktuara, Bashkangjitur gjeni librat e votimit për të gjitha vendvotimet në komunën e Mamushës.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe vlerësoi ankesën dhe përgjigjen në ankesë ka gjetur se:

-Ankesa është e pabazuar.

Paneli pas shikimit të shkresave të lëndës, përgjigjes në ankesë të KQZ-së, vlerësoj se pretendimet në ankesën e subjekti politik Kosova Demokratik Turk Partisi (KDTP), me seli në Prizren, dega Mamushë, në të cilën kandidati për Kryetar të Komunës së Mamushës ka paraqitur shqetësime serioze lidhur me vlefshmërinë e votave të ardhura nga diaspora dhe dyshimet për keqpërdorime në procesin e votimit, ku ekziston dyshimi i bazuar se disa

persona të përfshirë në procesin e votimit nga diaspora kanë ushtruar të drejtën e votës në kundërshtim të drejtpërdrejtë me dispozitat kushtetuese dhe shqetësimi lidhur me vendvotimin 3201/04, ku ka pasur shkelje të procedurës së votimit me asistencë, për Panelin këto pretendime janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj për faktin se nga pretendimet e theksuara në ankesë parashtuesi i ankesës këto pretendime nuk ka arritur që të i vërtetoj se ka pasur shkelje apo parregullsi për të cilat pala ankuese pretendon me ankesën e tij, kjo pasi që paraqitësi i ankesës nuk i ka bashkangjitur ankesës asnjë provë dhe nuk ka arritur me ankesë të argumentoj pretendimet e tij të theksuara si më lartë, ndërsa pretendime e theksuara në ankesë tani për tani mbeten në nivel të supozimit nga se nuk janë argumentuar me fakte dhe me prova konkrete, por se këto pretendime nuk i ka mbështetur me asnjë provë konkrete dhe për më tepër këto pretendime janë të përgjithësuara.

Sa i përket pretendimeve të palës ankuese që mbështetet në deklarinimin e disa personave - votuesve, sipas vlerësimit të panelit bazuar në nenin 4 paragrafi 1.3 të LZP, liria dhe fshehtësia e votës janë të garantuara, gjer sa shpërfaqja e vullnetit të votuesve në parim cenon fshehtësinë e votës, prandaj edhe për këtë arsye nuk e mori parasysh këtë pretendim.

Andaj, Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla janë të përgjithësuara, të pa argumentuara dhe të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se nga veprimet e përshkruar në ankesë, parashtuesi i ankesës nuk ka arritur që të vërtetoj me asnjë provë të vetme se me këto veprime ka pasur shkelje të dispozitave ligjore të Ligjit për Zgjedhje apo të Rregullave Zgjedhore të KQZ-së.

Duke marrë parasysh të lartpërmendurat, Paneli vlerëson se parashtuesi i ankesës në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse, edhe pse në bazë të nenit 117 paragrafi 3 të Ligjit Nr.08/L-228 Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në të cilin nën përcaktohet se *“Vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”*.

Nga arsyet e theksuara më lartë dhe duke u bazuar në nenin 117 paragrafi 3, lidhur me nenin 118 paragrafi 1 të Ligjit Nr.08/L-228 Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA

ZL.Anr.333/2025 datë 25.10.2025



KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

AA.nr.101/2025

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Rustem Thaqi - kryetar i kolegjit, Lumni Sallauka dhe Nenad Lazic, anëtarë, lidhur me ankesën e kandidatit për Kryetar të Komunës së Mamushës Abdulhadi Krasaniç, nga subjekti politik Kosova Demokratik Turk Partisi (KDTP), me seli në Prizren - Dega në Mamushë, për Zgjedhjet Lokale, të mbajtura me datën 12 Tetor 2025, të paraqitur kundër vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), ZL.Anr.333/2025, të datës 25.10.2025, në seancën e mbajtur më datë 29.10.2025, merr këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET ankesa e kandidatit për Kryetar të Komunës së Mamushës Abdulhadi Krasaniç, nga subjekti politik Kosova Demokratik Turk Partisi (KDTP), me seli në Prizren - Dega në Mamushë, ndërsa vendimi i Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), ZL.Anr.333/2025, të datës 25.10.2025, VERTETOHET.

A r s y e t i m i

Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa, me vendimin ZL.Anr.333/2025, të datës 25.10.2025, ka vendosur: Refuzohet e pabazuar ankesa, ZL. Anr.333/2025 e datës 23.10.2025, e parashtruar nga kandidati për Kryetar të Komunës së Mamushës Abdulhadi Krasaniç nga subjekti politik Kosova Demokratik Turk Partisi (KDTP), me seli në Komunën Prizrenit - Dega Mamushë, të paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të parregullsive gjatë votimit, për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës të mbajtura më datën 12 Tetor 2025.

Kundër vendimit të PZAP, kandidatit për Kryetar të Komunës së Mamushës Abdulhadi Krasaniç, nga subjekti politik Kosova Demokratik Turk Partisi (KDTP), ka paraqitur ankesë në Gjykatën Supreme të Kosovës, me të cilën e konteston ligjshmërinë e tij, për shkak të shkeljeve të dispozitave të LZP-së, konstatimit të gabuar të gjendjes faktike, dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet si e bazuar ankesa, të prishet vendimi ZL.A.nr.333/2025 i datës 25.10.2025, i nxjerrë nga Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa.



PZAP, ka parashtruar përgjigje në ankesën e kandidatit për Kryetar të Komunës së Mamushës Abdulhadi Krasaniç, nga subjekti politik Kosova Demokratik Turk Partisi (KDTP), me të cilën e kundërshton në tërësi ankesën, me propozim që e njëjta të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës e vlerësoi ligjshmërinë e vendimit të atakuar, në kuptim të pretendimeve ankimore, përgjigjes në ankesë, dhe pas shqyrtimit edhe të shkresave të lëndës, gjeti se:

Ankesa është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se më datë 23.10.2025, PZAP-i, ka pranuar ankesë nga kandidati për Kryetar të Komunës së Mamushës, përkatësisht subjekti politik Kosova Demokratik Turk Partisi (KDTP), me seli në Prizren - Dega Mamushë, duke kërkuar saktësisht si në ankesën e paraqitur, në PZAP.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka ushtruar përgjigje në ankesë, me të cilën e ka kundërshtuar në tërësi ankesën e kandidatit për Kryetar të Komunës së Mamushës Abdulhadi Krasaniç nga subjekti politik Kosova Demokratik Turk Partisi (KDTP).

Pas pranimi të përgjigjes në ankesë të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, PZAP-i, ka nxjerr vendimin ZL.Anr.333/2025, të datës 25.10.2025, me të cilën e ka refuzuar ankesën e kandidatit për Kryetar të Komunës së Mamushës Abdulhadi Krasaniç nga subjekti politik Kosova Demokratik Turk Partisi (KDTP), duke vendosur si në dispozitiv të vendimit.

PZAP, në arsyetim të vendimit të saj ndër të tjera ka theksuar se: Paneli pas shikimit të shkresave të lëndës, përgjigjes në ankesë të KQZ-së, vlerësoj se pretendimet në ankesën e subjekti politik Kosova Demokratik Turk Partisi (KDTP), me seli në Prizren - Dega Mamushë, në të cilën kandidati për Kryetar të Komunës së Mamushës ka paraqitur shqetësime serioze lidhur me vlefshmërinë e votave të ardhura nga diaspora dhe dyshimet për keqpërdorime në procesin e votimit, ku ekziston dyshimi i bazuar se disa persona të përfshirë në procesin e votimit nga diaspora kanë ushtruar të drejtën e votës në kundërshtim të drejtpërdrejtë me dispozitat kushtetuese dhe shqetësimi lidhur me vendvotimin 3201/04, ku ka pasur shkelje të procedurës së votimit me asistencë.

Sipas vlerësimit të PZAP, këto pretendime janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj për faktin se nga pretendimet e theksuara në ankesë parashtruesi i ankesës këto pretendime nuk ka arritur që të i vërtetoj se ka pasur shkelje apo parregullsi, për të cilat pala ankuese pretendon me ankesën e tij, kjo pasi që paraqitësi i ankesës nuk i ka bashkangjitur ankesës asnjë provë dhe nuk ka arritur me ankesë të argumentoj pretendimet e tij të theksuara si më lartë, ndërsa pretendime e theksuara në ankesë tani për tani mbeten në nivel të supozimit nga se nuk janë argumentuar me fakte dhe me prova konkrete, por se këto pretendime nuk i ka mbështetur me asnjë provë konkrete dhe për më tepër këto pretendime janë të përgjithësuara.

Ka shtuar se sa i përket pretendimeve të palës ankuese që mbështetet në deklarinimin e disa personave - votuesve, sipas vlerësimit të PZAP, bazuar në nenin 4 paragrafi 1.3 të LZP, liria dhe fshehtësia e votës janë të garantuara, gjerë sa shpërfaqja e vullnetit të votuesve në parim cenon fshehtësinë e votës, prandaj edhe për këtë arsye nuk e mori parasysh këtë pretendim. Andaj, Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla janë të përgjithësuara, të pa argumentuara dhe të



pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se nga veprimet e përshkruar në ankesë, parashtuesi i ankesës nuk ka arritur që të vërtetoj me asnjë provë të vetme se me këto veprime ka pasur shkelje të dispozitave ligjore të Ligjit për Zgjedhje apo të Rregullave Zgjedhore të KQZ-së.

Duke marrë parasysh të lartpërmendurat, PZAP ka vlerësuar se parashtuesi i ankesës në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse, edhe pse në bazë të nenit 117 paragrafi 3 të Ligjit Nr.08/L-228 Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në të cilin nen përcaktohet se: “Vendosja për ankesat nga PZAP-ja, mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”.

Gjykata Supreme e Kosovës, duke u nisur nga gjendja e tillë faktike dhe ligjore e çështjes, e pranon në tërësi si të drejtë dhe të bazuar qëndrimin juridik të PZAP-it, si në vendimin e tij, me të cilin e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e parashtuar nga kandidati për Kryetar të Komunës së Mamushës Abdulhadi Krasaniç, nga subjekti politik Kosova Demokratik Turk Partisi (KDTP), me seli në Prizren - Dega në Mamushë, lidhur me pretendimet për vlefshmërinë e votave të ardhura nga diaspora dhe dyshimet për keqpërdorime në procesin e votimit, ku ka pretenduar se ekziston dyshimi i bazuar se disa persona të përfshirë në procesin e votimit nga diaspora kanë ushtruar të drejtën e votës në kundërshtim të drejtpërdrejtë me dispozitat kushtetuese dhe shqetësimi lidhur me vendvotimin 3201/04, ku ka pasur shkelje të procedurës së votimit me asistencë, për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, të mbajtura më datë 12.10.2025.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore se vendimi i atakuar është përfshirë në shkelje të LZP-së. Sipas vlerësimit të kësaj gjykate, dispozitivi i vendimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e vendimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Sipas vlerësimit të kësaj gjykate, PZAP, në mënyrë të plotë i ka vlerësuar të gjitha rrethanat përkatësisht faktet e çështjes, mbi bazën e të cilave ka krijuar një pasqyrë të qartë, nga e cila rezulton se ankesa e paraqitur është e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se vendimi i PZAP, është i drejtë i kuptueshëm dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare nga vërtetohet se edhe e drejta materiale është zbatuar drejtë. Sipas nenit 23 dhe 28 të Ligjit Nr. 03/L-072 Për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, gjykata vlerësoi se drejtë janë zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale, të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, të cilat përshtatshmërisht zbatohen edhe për zgjedhjet lokale, përveç nëse përcaktohet ndryshe me anë të këtij ligji.

Gjykata Supreme e Kosovës, e pranojë si të drejtë dhe të ligjshëm vendimin e PZAP-së, edhe për zbatim të gabuar të së drejtës materiale për arsye se:

Me nenin 8 të Ligjit nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, përcaktohet se: *“1. KQZ-ja mban Listën e votuesve dhe siguron që e njëjta bazohet në të dhënat e sakta, të përditësuara dhe më të fundit të Regjistrat Qendror Civil dhe e cila në mënyrë sistematike largon nga lista personat e vdekur dhe personat që kanë hequr dorë nga shtetësia”,* si dhe nenit 83 [Lokacionet e Vendvotimeve dhe Qendrave të Votimit], ku përcaktohet se: *“2. Secilit votues të regjistruar i caktohet Qendra e Votimit që është lokacioni ku emri i tij/saj*



shfaqet në Listën Përfundimtare të Votuesve të përdorur gjatë mbajtjes së votimit në ditën e zgjedhjeve”.

Me nenin 64 paragrafi 2, nënparagrafi 2.7, të Ligjit nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, përcaktohet se: “2. KQZ-ja i: 2.7. certifikon listën votuese lidhur me zgjedhjet”.

Me nenin 95 paragrafi 2, të këtij ligji, përcaktohet se: “2. KQZ-ja në vazhdimësi, bashkë me institucionet tjera, merr hapa për të përmirësuar listën votuese edhe në periudha jo zgjedhore”.

Me nenin 3 paragrafi 1, 2 dhe 3 të Rregullores Zgjedhore nr.03/2024, për Krijimin, Kundërshtimin dhe Konfirmimin e Listës Votuese, dhe Rregullores Zgjedhore NR.02/2025 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Zgjedhore NR.03/2024 Krijimi, Kundërshtimi dhe Konfirmimi i Listës së Votuesve, përcaktohet se: “1. KQZ mban LV dhe siguron që e njëjta bazohet në të dhënat e sakta, të përditësuara dhe më të fundit të Regjistrat Qendror Civil (RQC), dhe në mënyrë sistematike largon nga lista personat e vdekur dhe personat që kanë hequr dorë nga shtetësia. Kjo listë, përmban: 1.1. Ekstraktin e fundit në dispozicion nga RQC të të gjithë personave me të drejtë vote, të cilët janë regjistruar si shtetas të Republikës së Kosovës, sipas Ligjit për Shtetësinë; 1.2. Të gjithë shtetasit që jetojnë jashtë Kosovës, të cilët pas regjistrimit të suksesshëm, janë përfshirë si votues jashtë Kosovës. 2. Me qëllim të saktësimit të LV dhe konfirmimit të së drejtës për votim, KQZ kërkon informata, duke përfshirë, por pa u kufizuar, në bazën e të dhënave dhe regjistrat e institucioneve kompetente: Agjencisë së Statistikave të Kosovës, Agjencisë Kadastrale, Agjencisë për Regjistrim Civil dhe Administratës Pensionale. 3. Shërbimi votues (SHV) brenda njëzetë e katër (24) orë pas shpalljes së zgjedhjeve kërkon nga Agjencia për Regjistrim Civil (ARC) ekstraktin e parë (1) të RQC, i cili duhet të pranohet nga KQZ, jo më vonë se dy (2) ditë pas kërkesës”.

Me nenin 5 të Rregullores Zgjedhore Nr.02/2025 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Zgjedhore Nr.03/2024 Krijimi, Kundërshtimi dhe Konfirmimi i Listës së Votuesve, me të cilin riformulohet neni 6 i saj, përcaktohet se: “Periudha kundërshtimit dhe konfirmimit fillon, jo më vonë se pesë (5) ditë pas publikimit të listës preliminare të votuesve dhe përfundon, jo më vonë se dy (2) ditë pas përfundimit të periudhës për ndërrimin e QV”.

Gjykata Supreme e Kosovës, nga shqyrtimi i shkresave dhe nga interpretimi i dispozitave të cituara, erdhi në përfundim se ankesa e paraqitur është në tërësi e pabazuar.

Sipas vlerësimit të kësaj gjykate, pretendimet ankimore se një pjesë e votuesve nga diaspora nuk e kanë pasur shtetësinë e Republikës së Kosovës dhe edhe përkundër kësaj të njëjtit kanë figuruar në listën e votuesve dhe kanë votuar, janë të pabazuara. Në këtë rast paraqitësi i ankesës me provat që ka bashkangjitur me ankesë në PZAP, dhe me ankesën në këtë gjykatë nuk ka arritur të dëshmojë faktin se pretendimet e tij, janë të bazuara.

Për më tepër kjo gjykatë vlerëson se lista e përpilimit të votuesve është certifikuar nga KQZ, më 6 shtator 2025 dhe ndaj saj pala ankuese nuk ka parashtruar ankesë, edhe pse ka pas afatin e paraqitjes së ankesës nga momenti i certifikimit të listës nga KQZ, lidhur me Listën Votuese, afat i cili ka përfunduar më datën 5 shtator 2025.



Përveç kësaj KQZ, në përgjigjen në ankesën e ankuesit të parashtruar në PZAP, në mënyrë të detajuar ka paraqitur procesin e verifikimit të votuesve, në bashkëpunim me organet tjera kompetente dhe si rezultat i verifikimit ka nxjerr edhe listën përfundimtare.

Në këtë rast kjo gjykatë, vlerëson se pretendimet ankimore sa i përket kësaj çështje janë pa ndikim me rastin e vendosjes, për arsye se edhe sikur të qëndronin si të tilla në këtë fazë të procedurës nuk mund të shqyrtohen e as të jenë objekt shqyrtimi sepse PZAP, në këtë fazë të procedurës nuk mund të shqyrton listën e votuesve, e cila listë është certifikuar me datë 06 shtator 2025, pas përfundimit të afatit për ankesë. Lidhur me këtë Listën e votuesve të gjitha subjektet politike kanë pasur të drejtën ta kundërshtojnë brenda afateve duke përfshirë edhe subjektin ankues, por jo tani në fazën e shqyrtimit të ankesës, që i referohet parregullsive në ditën e votimit.

Për me tepër, duhet theksuar se të gjithë personat që janë të përfshirë në listë të votuesve *“me apo pa të drejtë me qenë pjesë e listës”*, kanë të drejtën e votës përderisa gjenden në listën e votuesve, përderisa lista si e tillë nuk është atakuar asnjëherë pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Në këtë kontekst kjo gjykatë, vlerëson se bazuar në dispozitat e cituara përgjegjësia për saktësinë e listës së votuesve bie mbi KQZ-në, ndërsa çdo kontestim ndaj saj duhet të paraqitet brenda afatit të përcaktuar, përndryshe çështja nuk mund të shqyrtohet në këtë fazë të procesit zgjedhor. Duke qenë se pala që paraqitur ankesë nuk ka dëshmuar asnjë fakt konkret që të vërtetojë ndikimin real në rezultatin zgjedhor dhe për shkak se lista e votuesve është dokument përfundimtar dhe i pakontestueshëm pas certifikimit nga KQZ.

Në raport me pretendimet e ankuesit për parregullsi gjatë votimit me assistencë, lidhur me vendvotimin nr. 3201/04, kjo gjykatë i vlerëson se janë pretendime të pabazuara. Në këtë rast nga Libri i vendvotimit nr.3201/04, dhe shqyrtimi i të gjitha procesverbaleve, kjo gjykatë erdhi në përfundim se nuk kemi të bëjmë me parregullsi të cilat i pretendon ankuesi, për arsye se të gjitha procesverbalet janë të nënshkruara me rregull nga të gjithë anëtarët dhe në të njëjtën nuk ka të shënuar ndonjë vërejtje për parregullsi që do të dëshmonte se pretendimet e ankuesit janë të bazuara.

Nga arsyet e paraqitura dhe në bazë të nenit 118 paragraf 4, të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS

AA.nr.101/2025, datë 29.10.2025.



5

Kryetari i kolegjit,
Rrustem Thaqi

Republika e Kosovës
Republika Kosovo
SAKTËSINË E KOPJËS E VËRTETON
TAČNOST OTPRAVKA POTVRDUJE

Punëtori i autorizuar
Ovlašćeni radnik



GYJKATA SUPREME E KOSOVËS

FLETËDËRGESE PËR DORËZIM PERSONAL

DOSTAVITELICA ZA LICNO DOSTAVLJANJE

Sheji i shkresës
Oznaka spisa:

AA-101/2025

1. Pasi marrësi, i cili me tentimin e parë të dorëzimit nuk u gjet në vendin e ku është dëshitë të bëhet dorëzimi i sa pas lënjes së lajmërimit me shkrim që për shkak të dorëzimit të gjendet në kohën e caktuar në banesën apo në vendin e punës, se tij, dorëzimi është bërë: anëtarit madhor të familjes së marrësit - kujdestarit të ndëresës, fjet, personit që punon po në atë vend me marrësin.

1. Posto primilac, koji pri prvom pokušaju dostave nije zatečen na mestu gde se dostavljanje ima izvršiti ni posle ostavljenog pismenog obaveštenja da radi dostavljanja bude u određeno vreme u svom stan u radnom mestu, dostava je izvršena; odaslom članu domaćin. Primaoca nastojniku zgrace susedu licu zaposlenom na istom radnom mestu primaocem

2. Pasi marrësi ose anëtar i familjes së tij e refuzon marrjen e shkresës, shkresa u la në banesë në vendin e punës së marrësit (duke e ngjitur në derën e banesës ose të lokalit ku gjendet në punë marrësi).

2. Posto primilac odnosno član njenog domaćinstva odbio prijem, pismo je dostavljeno u stanu - radnom mestu primaoca (pribieno na vratima stana odnosno prostorije gde primilac zaposlen)

Më _____ 201____ në ora _____ cas.
dana _____ u _____
Shkaku i refuzimit të marrjes _____
Razlog odbijanja prijmea _____

Nëshkrimi i dorëzuesit - polpis dostavljaca

(Te panevojshmeve bjeri vize - nepotrebnje precrati)

Emri i shkresës që dorëzohet:

Naslov pisma koja se dostavlja:

AKT G7UKIM

29.10.2025

Numri i shitojcave:

broj priloga

2

Vërtetoi se mora shkresën e lartpërmendur më (me fjalë)

Povrdujemo prijem gorenavegenog pisma (i slovima)

31.10.2025 14:38

(Nëshkrimi i marrësit ose i atij që e ka marrë aktin në vend të tij)
Polpis primioa ili lica koje je pismeno primilo u zimeni)

V. SH

Nëshkrimi i dorëzuesit - polpis dostavljaca

Në rast se marrësi është analitet ose nuk është në gjendje të nëshkruajë dorëzuesit, duke shënuar shkaku pse marrësi nuk e ka vënë nëshkrimin e vet. Ako je primilac nepismen ili nije u stanju da se potpiše, potpisuje ga dostavljač. napomenom zasno primilac nije stavio svoj potpis.